

**DEKLARATË E ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-ut**

DEBATI I KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR UNMIK-un

NJU JORK, 24 PRILL 2020

z. Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Sigurimit,

Më lejoni të filloj duke ua shprehur ngushëllimet të gjithëve në zonën tonë të

Misionit, jetët e të cilëve janë prekur aq shumë nga pandemia e COVID-19.

Pandemia është një sfidë e paparë deri më tani për Kosovën dhe për

regjionin, dhe përkujtues që sfidat e tilla mund të zgjidhen vetëm përmes

bashkëpunimit regjional.

z. Kryetar,

Viktimat në njerëz kanë vazhduar të rriten si në Kosovë, ashtu edhe në regjion.

Në Kosovë, autoritetet e shëndetit publik, në konsultim me Organizatën

Botërore të Shëndetësisë dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, kanë vepruar

me shpejtësi në vendosjen e masave për zvogëlimin e përhapjes së

sëmundjes. Këto masa kanë përfshirë mbylljen e kufijve dhe kufijve

administrativë, kufizime të gjëra të lëvizjes, mbylljen e shkollave dhe të shumë

bizneseve private, si dhe izolimin e komunave të prekura më së shumti.

CHECK AGAINST DELIVERY

Kosova, me numrin e saj të vogël të popullatës dhe me resurse me të kufizuara, mbetet posaçërisht e rrezikuar ndaj kërcënimit të një përhapjeje më të madhe, apo ndaj rritjes së dukshme të rasteve më të rënda. Përkundër përpjekjeve heroike të stafit mjekësor, resurset shëndetësore në Kosovë janë duke arritur limitet e tyre.

Përveç kësaj, barra e madhe ekonomike dhe sociale e krizës shëndetësore në ekonominë e brishtë të Kosovës veçse ka filluar të ndjehet. Gjatë këtij muaji, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka miratuar një hua emergjente për Kosovën në vlerë prej 56.5 milionë \$, të dedikuara për sektorin shëndetësor dhe sektorët e tjerë të prekur nga kriza. Derisa Bashkimi Evropian sapo ka zotuar rreth 100 milionë euro si hua të favorshme për të ndihmuar në stabilizimin e ekonomisë dhe në tejkalimin e vështirësive të bilancit të pagesave. Disa shtete anëtare gjithashtu kanë filluar të rrisin përkrahjen e tyre të drejtpërdrejtë. Natyrisht, do të ketë nevojë për më shumë, së bashku me masa të fuqishme të monitorimit, transparencës dhe llogaridhënies, për t'u siguruar që ndihmesa të arrin tek njerëzit me më së shumti nevojë.

z. Kryetar,

Bashkëpunimi ndërkombëtar në terren është unifikuar. UNMIK-u dhe ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë janë në bashkëpunim të ngushtë me

CHECK AGAINST DELIVERY

autoritetet vendore të shëndetit publik dhe me të gjithë partnerët tonë ndërkombëtarë. Ashtu siç është edhe e pritshme, UNMIK-u është duke e përshtatur punën e tij, duke qëndruar i bashkuar me popullin e Kosovës në luftimin e pandemisë COVID-19. Misioni ka rishikuar punën e tij programatike për vitin 2020. Në mesin e përshtatjeve të tjera, UNMIK-u është duke ofruar ndihmesë të drejtpërdrejtë komunave dhe komuniteteve që janë më të rrezikuara. Platforma jonë në internet dhe ekipi për komunikim janë duke bashkëpunuar me mediet vendore dhe partnerët në përpilimin dhe shpërndarjen e informatave shëndetësore në partneritet me ekipin e OKB-së në Kosovë. Gjithashtu, kam qenë në kontakt personal me udhëheqësit e regjionit, duke përfshirë kryeministrin e Shqipërisë, z. Rama, dhe presidentin e Serbisë, z. Vuçiq, për të kërkuar ndihmesën e tyre në avancimin e reagimit përfshirës dhe të njësuar. UNMIK-u dhe UN Women po e përshpejtojnë mbështetjen e vazhdueshme për strehimoret dhe reagimet e tjera ndaj dhunës në familje, ku vetëm gjatë muajit mars numri i rasteve të raportuara është ngritur për 36%. Së këndejmi, jemi duke i përcjellë nga afër implikimet e pandemisë në të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe në të drejtën e privatësisë. Po ashtu, kemi ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e shëndetit dhe sigurisë të punonjësve të Misionit, ku deri më sot nuk kemi regjistruar raste të COVID-19 në mesin e punonjësve të Misionit tonë apo të punonjësve të tjerë të OKB-së në Kosovë.

z. Kryetar,

Siç na ka treguar përvoja, arritja e suksesit në mposhtjen e virusit COVID-19, së paku kërkon si në vijim, (i) një qeveri të fokusuar, (ii) mobilizimin e popullatës dhe të resurseve dhe (iii) udhëheqje të fuqishme. Është një karakteristikë fatkeqe e rrethanave të tanishme në Kosovë, ku ndasitë politike kanë shpërqendruar vëmendjen e shumë udhëheqësve nga kriza shëndetësore. Këto ndasi kanë ndikuar në rënien e besimit të qytetarëve ndaj udhëheqësve politikë gjatë kohës së një ankthi dhe pasigurie të rritur të popullsisë. Që nga përfundimi i periudhës raportuese, gjendja politike në Prishtinë është karakterizuar me polarizim të partive dhe me garë për pushtet mes tyre. Kjo është manifestuar në mospajtime të mëdha si brenda koalicionit qeveritar, ashtu edhe mes qeverisë dhe Presidentit rreth një numri çështjesh, duke filluar nga reagimi ndaj pandemisë, heqja e tarifës në mallrat serbe e deri te dialogu me Beogradin. Këto agjenda kundërthënëse kanë kulmuar me votën e mosbesimit ndaj koalicionit qeverisës më datën 25 mars, mu në kohën kur kriza e COVID-19 ishte duke goditur. Tani kemi një qeveri në detyrë, por në kohën kur po ju flas, Presidenti ka ftuar shumicën alternative që të formoj qeverinë e re, përderisa Kryeministri e ka quajtur këtë veprim si të paligjshëm, duke u zotuar se do ta kundërshtoj në Gjykatën Kushtetuese. Cilët do hapa që mund të pasojnë, ka javë që pakënaqësia qytetare është e dukshme. Është thelbësore

CHECK AGAINST DELIVERY

që pasiguritë politike të mos komplikojnë veprimet e unifikuara në luftimin e pandemisë.

z. Kryetar,

Jostabiliteti i brendshëm politik mund të ketë si rrjedhojë ballafaqimin e Kosovës me sfidat të tjera në bashkimin e përpjekjeve më të gjëra në luftimin e krizës. Megjithatë, dëshiroj që njëkohësisht të theksoj shembuj të shumtë të bashkërendimit pozitiv ndërkomunitar dhe ndërmjet kufijve administrativë atëherë kur më së shumti kishte nevojë. Zyrtarët shëndetësorë në Prishtinë, në veri të Kosovës dhe në Beograd kohëve të fundit kanë krijuar një komunikim dhe bashkërendim më të mirë, i cili mungonte në fillim të krizës. Artikujt esenciale kanë lëvizur më lirshëm përgjatë kufijve administrativë, ndërsa qeveria e Serbisë së fundmi ua dha donacion një numër testesh autoriteteve shëndetësore të Prishtinës, pavarësisht se disa figura publike në Prishtinë vendosen të reagojnë negativisht përgjatë linjave nacionaliste. Solidariteti i treguar mes profesionistëve dhe zyrtarëve kryesorë mjekësorë që shkonte përtej ndasive etnike e politike, jep shpresë që bashkëpunimi mund të rritet edhe më shumë, duke parë që edhe shkalla e infeksioneve vazhdon të rritet.

z. Kryetar,

Heqja e tarifës 100 për qind në importe nga Serbia e Bosnje Hercegovina për një periudhë fillestare së bashku me futjen e masave të reciprocitetit ndaj

CHECK AGAINST DELIVERY

Beogradit, është mirëpritur nga disa, edhe pse nga disa të tjerë është parë si e pamjaftueshme, pavarësisht se ky vendim shënoi një hap përpara, ku rifilluan marrëdhënie më të rregullta komerciale dhe u pa një kthim drejt parimeve të Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Ky është edhe një sinjal i rëndësishëm drejt rifillimit të dialogut politik mes Beogradit dhe Prishtinës. Po ashtu, dëshiroj të vë në pah se Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit ka votuar për miratimin e marrëveshjes me operatorin e Kosovës KOSTT, një e arritur kjo e rëndësishme për avancimin e efijencës së energjisë në regjion dhe për zbatimin të marrëveshjes për energji, të lehtësuar nga BE-ja.

Edhe pse ende nuk ekziston një rrugë e qartë për vazhdimin e dialogut, së paku ekzistojnë sinjale se vëmendja vazhdon të jetë e fokusuar në këtë çështje, madje edhe kur emergjenca COVID-19 konsiderohet me prioritet. Mirëpres emërimin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian të ngarkuar me çuarjen përpara të dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit. Nismat e fundit të përbashkëta lidhur me infrastrukturën dhe transportin, të iniciuara nga i Dërguari i Posaçëm Presidential i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, kanë shënuar një shembull tjetër të angazhimit praktik që është i mundur kur kemi vullnet të ndërsjellë politik dhe përkrahje ndërkombëtare. Nëse shikojmë pak më larg, një qasje e bashkërenduar ndërkombëtare në përkrahje të dialogut të ndihmuar nga BE-ja mes Prishtinës dhe Beogradit do të jetë thelbësore, ku kjo

CHECK AGAINST DELIVERY

mbetet edhe shpresa jonë më e madhe për arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe për paqe të qëndrueshme.

z. Kryetar,

Kjo krizë ka testuar përparësitë dhe dobësitë e shteteve dhe territoreve anëtare të OKB-së anekënd botës. Në përmbyllje, do të dëshiroja t'ua shpreh respektin tim atyre udhëheqësve dhe profesionistëve në të F që janë duke përkrahur njëri-tjetrin në luftimin e pandemisë. Gjithashtu, ftoj udhëheqësit politikë që ta ndjekin shembullin e tyre, si dhe të përqendrohen në unifikimin e energjive të tyre dhe në lënien mënjanë të agjendave personale e politike. UNMIK-u dhe ekipi i OKB-së në Kosovë, si dhe partnerët tonë do të vazhdojnë me dedikimin e resurseve dhe njohurive tona personale e kolektive për të ndihmuar. Dëshiroj ta shfrytëzojë mundësinë që të kërkoj ndihmë të mëtejshme të drejtpërdrejtë për Kosovën në mënyrë që t'i adresojë nevojat e saj shumë urgjente shëndetësore dhe të kujdesit social. Ashtu siç ka theksuar edhe Sekretari i Përgjithshëm, vetëm përmes solidaritetit dhe bashkimit të përpjekjeve mund të korrin sukses në ballafaqimin me këtë sfidë enorme dhe në tejkalimin e saj.

I falënderoj të gjithë anëtarët e Këshillit të Sigurimit për përkrahjen e tyre të vazhdueshme të UNMIK-ut.